

## Komunikatë për Shtyp

Shkodër, Gur i Zi, më 1.06.2010

Qendra Komunitare Gur i Zi, ditën e martë datë 1 Qershor, 2010, nga ora 11.00 – 12.45, organizoi në ambjentet e saj festimin e “Ditës së Fëmijëve”.

Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve që kryhen në kuadër të grantit nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) nëpërmjet Norway Trust Account. Ky grant akordohet për asistencën teknike për monitorim-vlerësimin dhe vizibilitetin e Programit “Rrugët Dytësore e Lokale”.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin autoritete të Qarkut Shkodër, përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit, nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Komunës Gur i Zi, banorë të fshatrave përreth, si dhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Aktiviteti u hap nga Z. Broz Marku, Kryetar i Komunës. Përfaqësuesi i FSHZH-së përshëndeti pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Më tej aktiviteti vijoi me një ekspozitë, ndeshje shahu midis finalistëve më të mirë në shkallë komune, vizitën e panairit me punime artizanale të zonës, konkursin e lules më të bukur si dhe me një program artistik. Aktiviteti vazhdoi me dhënien e çmimeve për pikturën më të mirë dhe shahistin fitues. Në fund të aktivitetit u krye edhe pastrimi i mjedisit përreth komunës nga nxënësit e gjimnazit si dhe u shpërndanë fletëpalosje për sigurinë rrugore dhe mirëmbajtjen e saj.

Ky aktivitet u organizua në kuadër të informimit publik lidhur me realizimin e punimeve për segmentin rrugor “Lezhë-Kallmet-Nënshat-Vau i Dejës” me gjatësi 33.7 km dhe gjerësi 5.8 m përfundoi në Gusht 2010. Financimi i këtij projekti me vlerë prej 774 milion lekë u mundësua nga OFID (Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar) dhe CEB (Banka Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës) në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” që po implementohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një institucion që nxiti një zhvillim social-ekonomik të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Aktualisht FSHZH po realizon projektin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri”, projektin e “Ujësullësave Ruralë ” si dhe projektin “Punët Në Komunitet III”. Këto projekte mundësohen me financimet e Bankës Botërore, Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Banka Gjermane KFW, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), Banka Europiane e Investimeve, Banka Islamike për Zhvillim etj.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që nga krijimi i tij në 1993, ka realizuar 166 projekte infrastrukture në Qarkun Shkodër. Nga këto investime, 81 objekte të infrastrukturës parësore janë implementuar deri më sot vetëm në rrethin e Shkodrës ku përfshihen rikonstruksione segmentesh rrugore, ndërtime shkollash, ndërtesash publike, projekte ujitjeje dhe ujësullës-kanalizimesh. Vlera totale e projekteve të financuara në rrethin e Shkodrës arrin shifrën 1,200,000,000. Për periudhën 2009-2010, në rrethin e Shkodrës FSHZH është duke implementuar 6 nënprojekte të infrastrukturës parësore me një vlerë prej 355, 000, 000 lekë.